



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/24;

Datë: 06.09. 2021

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nenit 22 paragrafi 4 të statutit të komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 00/00) dhe nenit 3 paragrafët 1,2,3,4 dhe 5 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.08.2021 nxjerrë:

V E N D I M

për formimin e Grupit të punës për hartimin e programit tre (3) vjeçar të banimit

I. Me këtë vendim formohet Grupi i punës për hartimin e Programit trevjeçar të Banimit për banorët e Komunës së Junikut / në tekstin e mëtejme Grupi i punës/.

II. Grupi i punës ka për detyrë që të hartojë Programin trevjeçar të Banimit për banorët e Komunës së Junikut në përputhje me nenin 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, nenin 3 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut.

III. Grupin e punës e përbëjnë nga një përfaqësues i subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, dhe gjashtë përfaqësues nga ekzekutivi i komunës .

IV. Grupi punues përbëhet nga:

1. Albert Gjocaj- (AAK),
2. Florim Shala-(LVV),
3. Zeqë Hebibi- (LDK),
4. Hasan Krasniqi-nga ekzekutivi komunal ,
5. Leonita Jasiqi- nga ekzekutivi komunal,
6. Myrtë Velijaj-, nga ekzekutivi komunal,
7. Demë Ukaj- nga ekzekutivi komunal,
8. Avdyl Maloku- nga ekzekutivi komunal dhe
9. Xhevahire Krasniqi- nga ekzekutivi komunal.

IV. Afati i hartimit të Planit është më së largu deri në fund të muajit nëntor të këtij viti.

V. Pas hartimit të Planit nga ana e Grupit të punës, Plani i dërgohet Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut, dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

